

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

ALBANIA

ICIC XV

**Empowering Individuals
through access to information:**
Ensuring transparency and Inclusivity
in an Interconnected World

3 - 5 June, Tirana

INFORMIM DHE PRIVATËSI
Nr. 16

Përmbajtja

Kuvendi miraton ndryshimet në ligjin “Për të drejtën e informimit”	faqja 3
Letër falënderimi e ICIC për kontributin në fushën e të drejtës për informim	3
Standarde të larta për mbrojtjen e të dhënave personale	4
Transparencë për mirëqeverisje	5
Konferenca mbi digjitalizimin e proceseve zgjedhore	6
Rëndësia e hapësirës online për aksesin në informacion	6
Garantimi i të drejtave të qytetarëve	7
Hartimi i Kodit të ri Penal, takim konsultativ	8
Shërbimet digjitale dhe garantimi i të drejtave të individit	8
Asambleja e 45-të Globale e Privatësisë	9
Forcimi i transparencës proaktive për qeverisje të hapur	10
Zyra e Komisionerit në “Forum IX të OSBE për Zhvillimin e Medias”	10
Takim me studentë të Fakultetit të Drejtësisë	11
Java e integritetit	11
Konferenca Vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit	12
Të drejtat e njeriut, 75-vjetori i Deklaratës Universale të OKB	12
Takimi rajonal për mbrojtjen e të dhënave personale	13
Standardet e KiE për të drejtën e Informimit	13
Projekti “BE për Qeverisjen e Mirë”	13
Së bashku për transparencën e autoriteteve publike	14
Projekti “Mbështetje për pjesëmarrjen, përgjeshmërinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”	14
Panairi “InnFest 2023”	15
Panairi Ndërkombëtar i Tiranës	15

Revista **“Informim Dhe Privatësi”**

Redaksia: Redi Skënderaj, Alketa Koja, Segi Berberi, Denada Hysi, Brikena Tepelena.

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 16 , Dhjetor 2023


Print: Graphic Line-01

Kuvendi miraton ndryshimet në ligjin “Për të drejtën e informimit”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i mbledhur në seancë plenare ditën e enjte, datë 21.09.2023, miratoi ligjin nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.



Këto përmirësime dhe ndryshime kanë për qëllim forcimin akoma edhe më shumë të rregullave, mekanizmave dhe procedurave për njohjen me informacionin/dokumentacionin me karakter publik nga qytetarët. Ndër ndryshimet kryesore në këtë akt ligjor është përfshirja dhe zgjerimi i kompetencave të Komisionerit në fushën e të drejtës për informim, të cilat ishin të listuara në ligjin aktual për mbrojtjen e të dhënave personale. Roli i Zyrës së Komisionerit konsolidohet akoma edhe më shumë, duke forcuar mekanizmat mbikëqyrëse për ushtrimin në praktikë të kësaj të drejte individuale. Risi të tjera përfshijnë, forcimin e pozicionit të koordinatorit për të drejtën e informimit, duke përfshirë edhe një shpërblim të posaçëm mbi pagë apo përcaktimi i saktë dhe konkret i përgjegjësisë për mospërbushjen e dispozitave të legjislacionit për të drejtën e informimit. Po ashtu, janë rishikuar me ulje kufijtë e poshtëm të sanksioneve për dënimin e shkeljeve për mospërbushje të detyrimeve ligjore, duke synuar vendosjen e një raportimi më të drejtë dhe proporcional me të ardhurat në administratën publike.





Letër falënderimi e ICIC për kontributin në fushën e të drejtës për informim

Zyra e Komisionerit ka marrë një letër falënderimi nga Presidentja e Komitetit Ekzekutiv të organizatës, znj. Blanca Lilia Ibarra Cadena, gjatë muajit korrik 2024, për kontributin dhe pjesëmarrjen aktive në kuadër të veprimtarisë së Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit.

Ky vlerësim vjen si rezultat i angazhimit të autoritetit në iniciativat ndërvepruese për shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira me autoritete homologe, shoqërinë civile dhe partnerë, të cilët ndajnë qëllimin dhe objektivat e përbashkëta për promovimin dhe garantimin e të drejtës për informim dhe rritjen e transparencës së autoriteteve publike.

Edhe institucioni shqiptar, në letërën e tij të falënderimit, thekson se mbetet i përkushtuar për të vijuar bashkëpunimin dhe kontributin në veprimtarinë e ICIC, në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të organizatës dhe më gjerë.



Standarde të larta për mbrojtjen e të dhënave personale

Zyra e Komisionerit zbatoi përgjatë vitit 2023 me Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qendrueshëm (ASDO), me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Tiranë, projektin “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave në Shqipëri”.

Në ceremoninë e mbylljes së tij u theksua

qasja ndërgjegjësuere, si një nga mënyrat efikase për forcimin e kulturës së respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve. Në këtë takim, morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, nga bota akademike, shoqëria civile dhe biznesi.



Z. Besnik Dervishi, vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin në kuadër të projektit dhe tha se “është një nga përvojat më të mira që institucioni ka patur ndër vite. Cilësia që ka prekur ky projekt është shumë e lartë, me takime me përfaqësues nga sistemi bankar, sektori shëndetësor, bota akademike, arsimi parauniversitar, etj. Miratimi dhe hyrja në fuqi e legjislacionit të ri të mbrojtjes së të dhënave personale, është një sfidë jo vetëm për Zyrën e Komisionerit. Institucioni ka programuar një fushatë të gjerë ndërgjegjësuere, pikërisht, për rëndësinë që ka përdorimi i sigurt dhe me standardet më të larta i të dhënave personale të

qytetarëve, si nga kontrolluesit publik, ashtu edhe nga ata privat”.

Për të pranishmit, u prezantua platforma inso.al, e cila ka si objektiv edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave personale apo dhe mundësinë e ofrimit të trajnimeve për profesionistë të këtyre fushave. Njëkohësisht, u paraqit dhe studimi mbi “Vlerësimin e nivelit të ndërgjegjësimit për sigurinë e informacionit, mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë kibernetike në Shqipëri”, i kryer përgjatë periudhës së zbatimit të projektit kryesisht me organizata dhe biznese.

Ndër gjetjet dhe rekomandimet kryesore të tij janë ato për: njohjen e kuadrit ligjor të fushës; hartimin e planeve/masave të detajuara të sigurisë së të dhënave dhe atyre kibernetike; përditësimin e vazhdueshëm të pajisje e sistemeve dhe përcaktimin e procedurave në rastet e cenimit të tyre apo të të dhënave; trajnimin në vijimësi të stafit, etj. Zyra e Komisionerit mirëpret dhe është e gatshme për të bashkëpunuar në realizimin e çdo iniciative që ka në qendër garantimin e kësaj të drejte të qytetarëve. Përparimi teknologjik dhe digjitalizimi mundëson që shumë procese dhe shërbime të kryhen në mënyrë të automatizuar. Cilësia dhe siguria e tyre e lartë nuk mund të kuptohet pa një mjedis të përshtatshëm kibernetik, kombinuar kjo edhe me përmbushjen e detyrimeve ligjore në procesin e përpunimit të të dhënave personale.



Transparencë për mirëqeverisje

Në kuadër të Ditës për të Drejtën e Informimit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë u organizua aktiviteti për nxitjen e transparencës përgjegjshmërisë dhe mirëqeverisjes. Në këtë takim ndërgjegjësues ishin të pranishëm nëpunës të njësisë më të madhe të vetëqeverisjes vendore në vend.



Komisionerit është partner i çdo autoriteti publik, i çdo aktori të shoqërisë civile apo medias dhe patjetër, një derë e hapur për çdo qytetar, pasi kjo është një e drejtë dhe liri themelore e sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë” - theksoi Komisioneri Dervishi, në fjalën e tij përshëndetëse.

Kryetari i Bashkisë, z. Erion Veliaj e vlerësoi si një lajm shumë të mirë faktin që Tirana do të jetë mikpritëse e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) në 2024, duke e kthyer kryeqytetin në qendër graviteti globale. *“Transparenca nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një mision dhe Bashkia ka angazhuar shumë resurse për këtë qëllim. E drejta për informim nuk është një privilegj, por një domosdoshmëri për një shoqëri të lirë, ajo është një e drejtë dhe liri themelore” – tha ndër të tjera ai.*



Për të pranishmit u prezantuan pikat kryesore të legjislacionit të përmirësuar, si dhe raste nga praktika e veprimtarisë së autoriteteve publike dhe Zyrës së Komisionerit. Një nga çështjet kryesore të trajtuara ishte ajo e transparencës proaktive (Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve), në funksion të përditësimit të vazhdueshëm të informacionit në shërbim të qytetarëve. Njëkohësisht, u theksua se forcimi dhe konsolidimi i rolit të koordinatorit brenda strukturës institucionale, shërben për më shumë përgjegjshmëri në ushtrimin e funksioneve publike. Prej vitit 2019 kjo datë është njohur zyrtarisht nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Me këtë rast, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të ICIC, pjesë e të cilit prej vitit 2021 është edhe Komisioneri shqiptar, përgatitën një video-mesazh ndërgjegjësues.



https://www.youtube.com/watch?v=I7_NklrEU1g



Konferenca mbi digjitalizimin e proceseve zgjedhore

Në konferencën me temë “Digjitalizimi i proceseve zgjedhore, perspektivat mbi sigurinë kibernetike dhe koordinimin ndërinstitucional në Ballkanin Perëndimor” i ftuar ishte dhe Komisioneri, z. Besnik Dervishi.

Në fjalën e mbajtur në panelin “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kryesore shtetërore e joshtetërore dhe institucioneve të administrimit të zgjedhjeve në mbrojtjen e integritetit dhe besueshmërisë së zgjedhjeve”, z. Dervishi theksoi ndër të tjera,

se “fushat e përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit, e drejta për informim dhe ajo për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërlidhen me veprimtarinë e KQZ, si për transparencën ashtu dhe për zhvillimin e proceseve të rregullta zgjedhore. Në këtë këndvështrim, identifikimi daktiloskopik dhe votimi elektronik janë elementë të rëndësishëm në kuadër të digjitalizimit të zgjedhjeve, në funksion të ushtrimit të të drejtës së votës nga qytetarët shqiptarë. Ky proces zbatohet në harmoni me një tjetër të drejtë e liri themelore, atë të mbrojtjes së të dhënave të tyre personale. Kuadri ligjor shqiptar i fushës, por edhe aktet e rëndësishme ndërkombëtare - Konventa 108+ e Këshillit të Evropës dhe Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) e Bashkimit Evropian, përbëjnë garancitë e domosdoshme për adresimin e sfidave të procesit të digjitalizimit, për realizimin e të cilit kërkohet një bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve.”

Ky aktivitet u bashkëorganizua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (International IDEA) dhe Qendra për Sundimin e Ligjit të Universitetit të Helsinkit në Finlandë (Rule of Law Finland, University of Helsinki).

Rëndësia e hapësirës online për aksesin në informacion

Me temë “Rëndësia e hapësirës online për aksesin në informacion”, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) dhe Universiteti i Oksfordit në Britani, zhvilluan konferencën me rastin e 28 Shtatorit-Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit.

Në këtë aktivitet mori pjesë për të herë të parë edhe Zyra e Komisionerit, ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues

të institucioneve anëtare të Komitetit Ekzekutiv të ICIC, nga shoqëria civile dhe aktorë të tjerë që kontribuojnë në fushën e qasjes/aksesit në informacionin me karakter publik në nivel ndërkombëtar. Në fokus të diskutimeve ishte shkëmbimi i ideve për fuqizimin e standardeve për ushtrimin e kësaj të drejte, duke marrë në konsideratë zhvillimin e teknologjisë dhe hapësirës digjitale. Në këtë frymë, konferenca ishte e ndarë në tre panele të ndryshme, ku u diskutuan temat: “Lidhja me internetin si një mundësues i aftësisë për të ushtruar të drejtat, me një fokus të veçantë në aksesin në informacion”; “Teknologjia për demokracinë dhe zhvillimi i qendrueshëm” dhe “Perspektiva e gjyqësorit dhe rregullatorëve të informimit për aksesin dhe lidhjen në internet”.





Garantimi i të drejtave të qytetarëve

Në kuadër të projektit të përbashkët të Zyrës së Komisionerit dhe Prezencës në Shqipëri të OSBE u zhvilluan takimet e programuara në bashkitë Malësi e Madhe dhe Kavajë.

Qëllimi i tyre ishte vlerësimi i situatës mbi përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit në

të dy fushat e përgjegjësisë së autoritetit. Në këto aktivitete ishin të pranishëm Komisioneri, z. Besnik Dervishi; zyrtarët e lartë të OSBE, z. Cailean Maclean dhe z. Mauro Puzzo; kryetarët e bashkive respektive, z. Tonin Marinaj dhe z. Fisnik Qosja; si dhe përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këto NJVV apo edhe në bashki fqinje.

Gjatë takimeve u theksua rëndësia e përmbushjes së detyrimeve ligjore në të dy fushat, si në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, ashtu edhe për forcimin e etikës dhe përgjegjshmërisë për ofrimin me cilësi të shërbimeve për qytetarët. Në to u trajtuan, gjithashtu edhe elemente të ndryshëm të kuadrit rregullator në fuqi, ashtu si dhe raste nga veprimtaria monitoruese e mbikëqyrëse e Zyrës së Komisionerit në këto zona.



Nga ana tjetër, vëmendje iu kushtua njohjes me risitë e legjislacionit të ardhshëm kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, që përafrohet tërësisht GDPR, ashtu si dhe ndryshimeve e përmirësimeve në ligjin “Për të drejtën e informimit”,

duke përmirësuar ndjeshëm standardet për garantimin dhe respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore.

Aktivitetet përfshinë edhe komponentet e ndërgjegjësimimit të qytetarëve, nëpërmjet shpërndarjes së botimeve/fletëpalosjeve nga stafi i Zyrës së Komisionerit, si dhe shkëmbimin e praktikës së mirë në kuadër të transparencës me publikun.





Hartimi i Kodit të ri Penal, takim konsultativ

Hartimi i Kodit të ri Penal është një iniciativë e Ministrisë së Drejtësisë (MD) për të sjellë harmoni dhe modernizim në legjislacionin penal kombëtar në fuqi, duke patur parasysh ndryshimet e shpeshta në përmbajtjen e tij të kryera gjatë viteve.

Për këtë qëllim, u organizua një takim konsultativ me përfaqësues të autoriteteve më të rëndësishme në rang kombëtar. Në këtë aktivitet i ftuar ishte dhe Komisioneri, z. Besnik Dervishi, i cili vlerësoi dhe përkrahu iniciativën e MD për të krijuar një kuadër rregullator gjithëpërfshirës në fushën penale, që përputhet me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.


Veçanërisht, në lidhje me projektin për hartimin e Kodit të ri Penal, Zyra e Komisionerit ka paraqitur disa propozime, duke u bazuar në një analizë krahasimore me kodet penale të tre shteteve, atë gjerman, italian dhe francez, vende të cilat kanë të njëjtin sistem të së drejtës “Civil Law”. Kjo analizë krahasuese është kryer duke marrë në konsideratë, njëkohësisht, edhe raste nga praktika e punës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Zyra e Komisionerit ka evidentuar dispozita të cilat kanë nevojë të adresohen edhe në projekt-Kodin e ri Penal. Propozimet i janë përcjellë grupit të punës, ndërkohë, Zyra e Komisionerit mbetet e angazhuar për të dhënë kontributin e saj institucional për përfundimin me sukses të kësaj iniciative.

Shërbimet digjitale dhe garantimi i të drejtave të individit

Zyra e Komisionerit ishte e ftuar në Forumin e Shoqërisë Civile, të zhvilluar në Tiranë, në panelin me temë “Tejkalimi i pengesave digjitale”.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga institucione rregullatore të rajonit tonë, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile, rretheve akademike dhe medias. Zyra e Komisionerit prezantoi punën dhe ecurinë në kuadër të procesit të përshtatjes së legjislacionit kombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me GDPR të BE. Ky kuadër rregullator mundëson adresimin më të plotë të sfidave dhe problematikave në epokën digjitale, në funksion të garantimit më të mirë të të drejtave të qytetarëve. Legjislacioni i modernizuar,

njëkohësisht, do të ndikojë edhe në përmirësimin e shërbimeve digjitale, si dhe do të nxisë zbatimin e standardeve më të larta përsa i përket aspekteve të sigurisë së të dhënave. Forumi i Shoqërisë Civile u mbajt në vigjilje të Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit për vendet e Ballkanit Perëndimor.



Asambleja e 45-të Globale e Privatësisë

Asambleja Globale e Privatësisë (Global Privacy Assembly-GPA), aktiviteti më i rëndësishëm vjetor i fushës, zhvilloi punimet e edicionit të 45-të gjatë muajit tetor 2023. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga 169 autoritete anëtare e vëzhguese, nga shoqëria civile, bota akademike, grupet e interesit, media, etj, takimi u organizua nga Autoriteti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bermudas (OPC), nën moton “Valë, Dallgë, Rryma”. Gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur u miratuan 7 dokumente, të cilat do të nxisin forcimin e bazës rregullore në këtë fushë:

- Rezoluta mbi inteligjencën artificiale në çështjet e punësimit;
- Rezoluta për sistemet gjeneruese të inteligjencës artificiale;
- Rezoluta për arritjen e standardeve globale në mbrojtjen e të dhënave personale;
- Rezoluta për të dhënat personale shëndetësore;
- Rezoluta për mbrojtjen e të dhënave personale me perspektivë gjinore;
- Rezoluta për ngritjen e bibliotekës së GPA;
- Rezoluta për “Çmimin për të drejtat e njeriut dhe privatësinë”.



Punimet e Sesionit të Mbyllur u përqendruan në diskutimin e ndikimit të digjitalizimit në përpunimin e të dhënave personale; garantimin e të drejtave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. GPA miratoi raportet vjetore të Grupeve të Punës së organizatës, ndërsa me vendimmarrje unanime të anëtarësisë u pranuan në të me të drejta të plota apo me statusin e vëzhguesit 10 autoritete kombëtare dhe organizma të ndryshme.

Gjatë punimeve të Sesionit të Hapur diskutimet u përqendruan në 9 panele të ndryshme, ku u trajtuan tema me shumë interes për komunitetin e profesionistëve të privatësisë dhe më gjerë. Në to u fol për strategjitë e politikave për teknologjinë; problematikat e përdorimit të inteligjencës artificiale në optikën e kuadrit rregullator; nxitjen e ndërveprimit të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave me institucionet rregullore të fushave të tjera,

apo dhe raportin mes shërbimeve financiare dhe mbrojtjen e të dhënave. Tema të tjera që u ndoqën me interes nga të pranishmit ishin edhe ato në lidhje me vlerësimin e risqeve në këtë fushë; kuadri modern rregullator në raport me popullsitë indigjene; mekanizmat e transferimit ndërkombëtar të të dhënave dhe domosdoshmëria e bashkëpunimit; si dhe nevoja për më shumë veprim nga autoritet në funksion të garantimit të standardeve më të larta për mbrojtjen e të dhënave personale. U mbajt edhe ceremonia e Çmimit “Giovanni Buttarelli”, që ju akordua znj. Andrea Jelinek, ish-Kryetarja e parë e Bordit Evropian të



Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB) dhe aktualisht Komisionere e Austrisë, në vlerësim të kontributit të çmuar në këtë fushë.



Forcimi i transparencës proaktive për qeverisje të hapur

Zyra e Komisionerit ka nisur me takimin në Entin Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura (ERRU) zbatimin e projektit “Transparenca proaktive e institucioneve të pavarura”. Kjo iniciativë ka për qëllim që nëpërmjet komunikimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë të nxisë përmirësimin e instrumentit të Programit të Transparencës të këtyre autoriteteve publike, përgjegjshmërinë

në funksionimin e tyre dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Komisioneri Dervishi theksoi se qasja e institucionit është fokusuar te ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me autoritetet publike, po aq sa edhe te trajnimet e vazhdueshme, për krijimin e kulturës së transparencës dhe qeverisjes së hapur. *“Ky projekt është bazuar mbi përvojën pozitive që Zyra e Komisionerit ka nga një iniciativë e ngjashme me organet e vetëqeverisjes vendore. Projekti është i ndërtuar mbi tre komponentë: ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe autoriteteve publike; trajnimin e nëpunësve dhe diskutimin e problematikave; zgjidhjen/trajtimin e rasteve praktike gjatë ushtrimit të funksioneve institucionale”.*

Kryetari i ERRU, z. Ndriçim Shani, duke vlerësuar iniciativën tha se *“i është dhënë rëndësia e duhur transparencës dhe komunikimit me publikun për mbrojtjen e interesave të tij. Vëmendja është maksimale për t’iu përgjigjur kërkesave të kohës, duke përmirësuar dhe përditësuar në vazhdimësi aktet, procedurat dhe formatet”.*

Në këtë takim u diskutua mbi eksperiencën dhe praktikën e ERRU në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, plotësimin e përditësimit të Programit të Transparencës, Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve, apo dhe procesit të trajtimit të kërkesave të qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Zyra e Komisionerit në “Forum IX të OSBE për Zhvillimin e Medias”

Zyra e Komisionerit mori pjesë në “Forum IX për Zhvillimin e Medias”, i organizuar nga Prezanca në Shqipëri e OSBE. Aktiviteti me tematikë qendrore *“Udhërrëfyes për lirinë e medias: Krijimi i rrugës për më tepër mbrojtje të gazetarëve, pavarësi dhe integritet të medias”*, mbledhi së bashku përfaqësues të subjekteve mediatike, institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile.



Përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit i njohën të pranishmit me kuadrin rregullator në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe detyrimet për zbatimin e tij, në funksion të veprimtarisë së medias për informimin e publikut. Me modernizimin e legjislacionit në këtë fushë përmirësohen akoma edhe më shumë standardet për respektimin e kësaj të drejte dhe lirie themelore të qytetarëve. Në këtë frymë, edhe subjektet mediatike duhet të përshtasin mekanizmat e funksionimit të tyre, sidomos në epokën digjitale, për të garantuar balancë dhe proporcionalitet mes informimit të publikut dhe garantimit të të drejtave individuale. Diskutimet gjatë Forumit u përqendruan në rëndësinë thelbësore të transparencës, aksesit në informacion dhe verifikimit të fakteve, si mjete të fuqishme në luftën kundër korrupsionit dhe në përparimin e gazetarisë profesionale.

Takim me studentë të Fakultetit të Drejtësisë

Zyra e Komisionerit mikpriti në një takim njohës e ndërgjegjësues një grup studentësh të Departamentit të Drejtësisë Publike të Fakultetit të Drejtësisë (FD) në Universitetin e Tiranës.



Qëllimi i tij ishte informimi mbi rolin, funksionet dhe veprimtarinë e një prej tre institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, siç është edhe Zyra e Komisionerit. Në këtë takim, i zhvilluar në formën e një bashkëbisedimi të lirë, Komisioneri Dervishi, paraqiti kuadrin ligjor e rregullator për fushat e përgjegjësisë së institucionit, foli për nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, për rritjen e

përgjegjshmërisë dhe masave tekniko-organizative për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve, për aspekte e procese konkrete të punës apo dhe për veprimtarinë ndërgjegjësuese për respektimin e këtyre dy të drejtave. Aktiviteti u mbajt si pjesë e projektit “Mjetet dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri” që Fakulteti i Drejtësisë po zhvillon me studentët e tij.

Java e integritetit

Në kuadër të “Javës së integritetit”, Zyra e Komisionerit së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, organizuan një forum diskutimi në mjediset e Fakultetit të Drejtësisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë të politikave antikorrupsion, të së drejtës për informim, si edhe studentë e staf akademik. Njëkohësisht, në takim ishin edhe përfaqësues nga Zyra Rajonale për Evropën Juglindore e UNODC (struktura kundër drogës dhe krimit), e cila jep një kontribut në mbështetjen e zbatimit të Konventës së OKB kundër korrupsionit në vendin tonë. Të pranishmit u njohën me rolin dhe funksionet e koordinatorit kombëtar kundër korrupsionit, si dhe me kuadrin ligjor që garanton transparencën e autoriteteve publike dhe ushtrimin e të drejtës për informim nga qytetarët. Rritja e integritetit dhe përgjegjshmërisë së institucioneve nëpërmjet zbatimit të mekanizmave rregullatore të fushës nxit aksesin në informacion/dokumentacion me karakter publik dhe ndikon në mirëqeverisje. Po ashtu edhe përfaqësuesit e Zyrës së UNODC prezantuan veprimtarinë e tyre për sa i përket luftës kundër korrupsionit në rajonin e Evropës Juglindore.



Zyra e Komisionerit i kushton rëndësi ndërveprimit dhe bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në kuadër të veprimtarisë mësimore akademike/didaktike të të rinjve, si një mundësi për zgjerimin e njohurive të tyre dhe përgatitjen e profesionistëve të së ardhmes.



Konferenca Vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit

Me tëmë kryesore “75 vjetori i Deklaratës Universale dhe 25-vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë: Evolucioni i të drejtave të njeriut në Shqipëri” zhvilloi punimet Konferenca Vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit.

I ftuar në panelin e parë të kësaj Konference, “25-vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë – Nevoja për interpretim Kushtetues dhe hapat për përmirësime legislative”, ishte edhe Komisioneri, z. Besnik Dervishi. Në fjalën e tij ai theksoi se “të drejtat e njeriut u japin zbatim parimeve të rëndësishme si dinjiteti, drejtësia, respekti dhe barazia. Ato vendosin standardet se si jetojmë dhe punojmë. Rrugëtimi i të drejtave të njeriut është një proces dinamik i kushtëzuar nga një sërë faktorësh ekonomik, social, politik, zhvillim teknologjik, etj. Për të garantuar gëzimin e tyre nga ana e qytetarëve, kërkohet qasje dinamike nga ana e institucioneve që sigurojnë apo që monitorojn zbatimin e tyre.”



Konferenca kishte në fokus vlerësimin e rrugëtimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë, raportin me kuadrin legjislativ dhe mundësinë e përmirësimit të tij, si dhe me sfidat me të cilat hasen nga qytetarët.



Të drejtat e njeriut, 75-vjetori i Deklaratës Universale të OKB

Në përkujtim të 75-vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të OKB, u zhvillua një tryezë diskutimi nën patronazhin e Prezencës në Shqipëri të OSBE.

Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 30 përfaqësues të

institucioneve të Avokatit të Popullit, Zyrës së Komisionerit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe nga organizata të shoqërisë civile të cilat në fokusin e tyre të veprimit kanë pikërisht promovimin e të drejtave të njeriut. Diskutimet në këtë tryezë u përqendruan në arritjet, sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra përgjatë vitit 2023 për të çuar përpara “lirinë, barazinë dhe drejtësinë për të gjithë qytetarët”.

Gjithashtu, duke qenë se liria dhe drejtësia janë të ndërlidhura me heqjen e barrierave burokratike dhe rritjen e respektit ndaj institucioneve në tërësi, takimi ofroi një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë civile për rolin e saj vendimtar për të promovuar e advokuar zbatimin e rekomandimeve të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut.



Takimi rajonal për mbrojtjen e të dhënave personale

Me iniciativën e degës në Maqedoninë e Veriut të Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GIZ), u zhvillua në Shkup një takim mbi mbrojtjen e të dhënave personale në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Të pranishëm në të ishin zyrtarë të lartë të autoriteteve të fushës nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bosnjë - Hercegovina dhe Serbia, të cilët shkëmbyen

përvojë me dy ekspertë nga Agjencia Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave.

Diskutimet u fokusuan te procesi i digjitalizimit të shërbimeve në raport me respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Një çështje tjetër me rëndësi që u trajtua në takim ishte raporti i vendeve të Ballkanit Perëndimor me GDPR dhe procesi i përafrimit të saj në legjislacionet kombëtare, vlerësimi i ndikimit në privatësi dhe sidomos, aspekte të sigurisë për të dhënat e ndjeshme. Njëkohësisht, përfaqësuesit e autoriteteve patën mundësinë të vlerësojnë edhe nevojat për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale dhe të bashkëpunojnë për hartimin e një strategjie rajonale për mbrojtjen e të dhënave.

Standardet e KiE për të drejtën e informimit

Me temë “E drejta për informim për dokumentet zyrtare, standardet e Këshillit të Evropës”, u mbajt në Poloni takimi për shkëmbimin e praktikave të mira në këtë fushë.

Zyra e Komisionerit mori pjesë në këtë aktivitet si përfaqësuese e ICIC dhe prezantoi përvojën në zbatimin e standardeve të Konventës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” të KiE. Një çështje tjetër me rëndësi që u diskutua në aktivitet ishte dhe veprimtaria në kuadër të bashkëpunimit dy dhe shumë-palësh për nxitjen e adoptimit të këtyre standardeve bashkëkohore jo vetëm në hapësirën gjeografike të Këshillit të Evropës, por edhe më gjerë. Ky aktivitet u mbajt në kuadër të Konferencës për të Drejtat e Njeriut të Varshavës 2023 (Human Dimension Conference) të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).



Projekti “BE për Qeverisjen e Mirë”

Zyra e Komisionerit është përzgjedhur si një nga institucionet shqiptare ku do të zbatohet projekti “Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë”.

Do të jenë tre komponentët e tij: forcimi i kapaciteteve institucionale dhe të koordinatorëve për zbatimin efektiv të standardeve bashkëkohore të parashikuar nga legjislacioni i modernizuar në fushën e të drejtës për informim (ligji 33/2022 dhe 45/2022); ofrimi i asistencës për të garantuar zbatimin efektiv të Konventës 108+ në fushën e

mbrojtjes së të dhënave personale; si dhe mbështetje për përmirësimin e procesit të trajtimit të kërkesave për informacion. Disa takime përgatitore janë zhvilluar për përcaktimin e modaliteteve të zbatimit të këtij projekti me ekspertët e tij, z. Tibor Draskovics dhe z. Zoran Jachevsi, si dhe për njohjen me rolin dhe veprimtarinë monitoruese e mbikëqyrëse të institucionit.


Së bashku për transparencën e autoriteteve publike

Zyra e Komisionerit zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe medias investigative. Qëllimi i tij ishte bërja e një bilanci të veprimtarisë vjetore në fushën e të drejtës për informim dhe shtimin e përpjekjeve për konsolidimin e kulturës së përgjegjshmërisë e të transparencës së autoriteteve publike.



Komisioneri, z. Besnik Dervishi, theksoi në fjalën e tij se *“komunikimi i vazhdueshëm me OjF, subjektet e medias investigative apo grupet e interesit është një praktikë e konsoliduar pune për institucionin. Ne kemi një mision të përbashkët dhe arritja e objektivave duhet të bazohet mbi frymën e bashkëpunimit dhe mirëbesimit të të gjithë faktorëve që kontribuojnë për t’i bërë më transparent autoritetet publike shqiptare.”*

Zyra e Komisionerit prezantoi ndryshimet dhe përmirësimet në ligjin për të drejtën e informimit, risi që kanë si objektiv përmirësimin e standardeve kombëtare, duke i sjellë ato më pranë atyre më bashkëkohore evropiane e ndërkombëtare. Të pranishmit vlerësuan punën dhe qasjen e Zyrës së Komisionerit dhe trajtuan çështje e problematika konkrete që janë të ndjeshme në veprimtarinë e tyre. Nga ana tjetër, u diskutua për shfrytëzimin e të gjitha mundësive për të ndikuar në rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin të autoriteteve publike në përmbushjen e detyrimeve për ushtrimin e plotë të të drejtës për informim.



Projekti “Mbështetje për pjesëmarrjen, përgjeshmërinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”

Institucioni bashkëpunoi me disa organizata dhe media investigative në zhvillimin e projektit “Mbështetje për pjesëmarrjen, përgjeshmërinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”, i financuar nga BE. Ky projekt u zhvillua në qytetet e Elbasanit,

Korçës, Tepelenës, Gjirokastrës, Shkodrës dhe Lezhës, ku të pranishëm ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarë. Në fokus ishte nxitja e ndërgjegjësimin dhe promovimi i të drejtës për informim, si dhe rëndësia e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në kuadër të kontrollit dhe pjesëmarrjes në qeverisje. Për këtë projekt u bashkëpunua me “Qendrën për Ekselencë Destiny”, “Together for Life”, “Balkan Investigative Reporting Network” (BIRN) dhe “Qëndresën Qytetare”.


Panairi “InnFest 2023”

Zyra e Komisionerit mori pjesë në “Festivalin e Inovacionit-InnFest 2023”, një aktivitet që kishte në qendër nxitjen e bashkëpunimit në ofrimin e shërbimeve inovatore në sektorin e tregtisë elektronike. Institucioni u përfaqësua me kontribut të rëndësishëm në dy panele, ku prezantimet përfshinë njohjen me kuadrin



rregullator në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aspektet kryesore të procesit të përpunimit të tyre gjatë ofrimit të shërbimeve nga ky sektor (informimi i qytetarëve, marrja/tërheqja e pëlqimit të tyre, masat e duhura tekniko-organizative, garantimin e sigurisë së të dhënave, etj).

Tregtia elektronike po njih zgjerim dhe përparim teknologjik edhe në vendin tonë, ku aspekti i ofrimit të shërbimeve në kushte të larta sigurie duhet të jetë përparësi për të gjithë aktorët që operojnë në këtë sektor. Institucioni u përfaqësua përgjatë ditëve të zhvillimit të aktivitetit me një stendë të posaçme, ndërsa kjo pjesëmarrje shërbeu për ndërgjegjësim, nxitje të kulturës për garantimin e të drejtave të qytetarëve, promovimin e veprimtarisë institucionale, apo dhe ndërveprimin e drejtpërdrejtë me grupet e interesit.



Panairi Ndërkombëtar i Tiranës

Zyra e Komisionerit mori pjesë në “Panairin Ndërkombëtar të Tiranës”, edicioni i 29-të, si një nga aktivitetet e rëndësishme për informimin, komunikimin dhe nxitjen e bashkëpunimit mes qytetarëve, institucioneve publike/shtetërore dhe komunitetit të biznesit.

Në kuadër të seminareve/trajnimeve të programuara si pjesë e agjendës së Panairit, Zyra e Komisionerit zhvilloi aktivitetin me temë “Siguria e të dhënave personale në Shqipëri dhe sfidat e digjitalizimit”. Në fokus ishte informimi dhe njohja me kuadrin rregullator në fuqi, parë në optikën e modernizimit të tij dhe përafrimit me GDPR. Të ndërthurur me shembuj nga praktika, prezantimet trajtuan zbatimin e standardeve më bashkëkohore në raport me sfidat që sjell transformimi teknologjik/digjital në ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe përgjegjshmëri. Aktiviteti shërbeu edhe si një mundësi për nxitjen e njohurive të profesionistëve të rinj dhe për shkëmbimin e ideve e tendencave në funksion të rritjes së kulturës dhe për një mjedis digjital sa më të sigurt.

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Përgatitet dhe botohet nga
Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Dhjetor 2023

**Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5
Kodi postar 1001
Tiranë
Tel: +355 42237200
Nr. i gjelbër: 08002050
www.idp.al
info@idp.al**

